



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 27.12.2023

Ref. KM-470/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.7/ 01 mars 2019, Prishtinë), nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.13/1 shtator 2011, Prishtinë), nenin 13 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës, bazuar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën 1: pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit për ri vlerësimin e verërave të prodhuara nga vjelja e vitit 2020 dhe 2021

1. Emërohet Komisioni, në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:
 - 1.1. Sadik Korenica, kryesues,
 - 1.2. Tasim Bajrami, sekretar,
 - 1.3. Rrahmon Kabashi, anëtar,
 - 1.4. Visar Hajrullaga, anëtar,
 - 1.5. Bekim N. Hoxha, anëtar,
 - 1.6. Nesim Morina, anëtar, dhe
 - 1.7. Ylber Kuqi, anëtar.
2. Nëse ndonjëri anëtar i komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi mungon, atëherë anëtar rezervë caktohet Ismajl Vehapi.
3. Komisioni obligohet të bëjë rivlerësimin organoleptik të mostrave të verës duke u bazuar në nenin 21, paragrafi 21.1 dhe 21.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës.

4. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi obligohet të bëjë rivlerësimin organoleptikë të mostrave të verës më datën 28 Dhjetor 2023, duke filluar në ora 10⁰⁰ në Zyrat e Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec.

5. Anëtarët e Komisionit nga pika 1 të këtij vendimi për punën e kryer do të kompensohen veç e veç nga pesëdhjetë euro (50€) për një anëtar sipas kërkesës të datës 08.12.2023 për ri vlerësim organoleptik të verërave të prodhuara nga Kompania “Wine & Art” sh.p.k. për tri tipe të verës së prodhuar nga vjelja e vitit 2020 dhe vjelja e vitit 2021, si vijon:

5.1. Merlot reserve – viti i vjeljes 2020, sasia 10 Hl;

5.2. Cabernet Franc – viti i vjeljes 2021, sasia 5 Hl, dhe

5.3. Cabernet Franc & Sheshi i Zi – viti i vjeljes 2021, sasia 9,5 Hl.

6. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi ka për detyrë që të hartoj raport të detajuar pune me shkrim për ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faton Peci

Ministër



Vendimi t'i dërgohet:

- *Anëtarëve;*
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm; dhe*
- *Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë, dhe*
- *Arkivit.*